



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	20.10.2021
Referenc-ë:	07-353/04-222436/21
Për/ Za/ To:	OJQ “Syri i Vizionit”
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorija për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën me nr. protokoll 07-353/04-222436/21 nga OJQ “Syri i Vizionit” me përfaqësues Naser Lajqi me të cilën kërkohet shfrytëzimi i hapësirës publike sheshi, “Skënderbeu” me datë 25 Tetor 2021 nga ora 10:00.

Qëllimi i kërkesës është realizimi i fushatës sensibilizuese me moton “ Dhuna nuk ka Justifikim” si pjesë e fushatës së promovimit të ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, ku do të bëhet vendosja e instalacionit “8 Silueta” me gjatësi 15.m dhe gjerësi 1m.

Ky instalacion do të qëndroj në shesh nga data 25 Tetor 2021 deri më 27 Tetor 2021.

Drejtorija pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin OJQ “Syri i Vizionit” për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “ Skënderbeu” me datë 25 Tetor 2021 me qëllim që të rritet vetëdija e shoqërisë në parandalimin e dhunës dhe ndëshkimin trupor ndaj fëmijëve. Instalacioni do të qëndroj në shesh nga data 25 deri me datë 27 Tetor 2021.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi;
- Pas përfundimit të aktivitetit hapësira të kthehet në gjendjen e mëparshme.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.